

Optima Communication Shpk
K71903025A
Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower, 5/4
PASQYRA FINANCIARE 2015

**Pasqyrat financiare
dhe Shenimet Shpjeguese
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015**

PËRMBAJTJA

	FAQJA
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN AKSIONAR	5
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7-18

Pasqyrat Financiare 2015

	Shënime	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
Aktive			
Aktive afatgjata materiale	4	4,296,309	5,185,360
Aktivët afatgjata jomateriale	5		
Kapitali i papaguar			
Totali i aktiveve afatgjata		4,296,309	5,185,360
Inventarë	6	-	-
Kërkesa për arkëtim	7	12,659,912	11,000,591
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	654,000	279,000
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	9	3,652,093	4,664,797
Totali i aktiveve afatshkurtra		16,966,005	15,944,388
Totali i aktiveve		21,262,314	21,129,748
Detyrime dhe kapitale të veta			
Kapitali i regjistruar	10	100,000	100,000
Kapitali i pa-regjistruar			
Kapitali i pa-paguar			
Rezerva			
Fitim /Humbje të mbartura		18,451,575	18,214,020
Fitim /Humbje Ushtrimore		663,797	237,555
Totali i kapitaleve të veta		19,215,372	18,551,575
Detyrime financiare – afatgjata			
Detyrime tatimore të shtyra			
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Furnitorë dhe detyrime të tjera	11	1,753,235	2,431,230
Detyrime financiare – afatshkurtra për taksa	11	293,707	146,943
Detyrime financiare – afatshkurtra			
Totali i detyrimeve afatshkurtra		2,046,942	2,578,173
Totali i detyrimeve dhe kapitaleve të veta		21,262,314	21,129,748

Shënimet shpjeguese në faqet 1-16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra përmledhëse e të ardhurave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë shprehur në LEK)

PASH 2015	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
I. Të ardhurat			
Te ardhura nga Sherbimi	12	10,106,065	10,163,449
Te ardhura të tjera	12	54,158	
Totali i të ardhurave (I)		10,160,223	10,163,449
II. Shpenzimet			
Shpenzime lidhur me përfitimet e punonjësve	13	(2,643,300)	(3,472,820)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	14	(4,500,535)	(4,269,220)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	4	(1,096,621)	(1,376,990)
Shpenzime të tjera, neto	14	(744,349)	(642,522)
Totali i shpenzimeve (II)		(8,984,805)	(9,761,552)
Fitimi nga veprimtaritë shfrytëzuese para kostove financiare		1,175,418	401,897
III. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare, neto			
Të ardhura (shpenzime) nga interesa bankare, neto	15	581	109
Të ardhura (shpenzime) nga kurset e këmbimit, neto	15	(100,899)	39,130
Komisione Banke	15	(66,680)	(65,508)
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare, neto (III)		(166,998)	(26,269)
Fitimi para tatimit		1,008,420	375,628
E ardhura tatimore	16	1,008,420	375,628
Fitimi (Humbja) e Vitit		344,623	138,073
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:			
Diferencat e këmbimit në përthimin e operacioneve të huaja		-	-
Fitim/(humbje) në rivlerësimin e pronës		-	-
Fitim/(humbje) në aktivet financiare të disponueshme për shitje		-	-
Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse të pjesëmarrjeve		-	-
Te ardhura të tjera totale gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Te ardhura gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Fitim/(humbje) i atribueshem për:			
Pronaret e shoqërisë meme		663,797	237,555
Interesa jo-kontrolluese		-	-
Fitimi/(humbja) për vitin		663,797	237,555
Te ardhura/(humbje) totale të atribueshme për:			
Pronaret e shoqërisë meme		663,797	237,555
Interesa jo-kontrolluese		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		663,797	237,555

Shënimet shpjeguese në faqet 1-16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit aksionar për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë shprehur në LEK)

PASQYRA E KAPITALIT	Kapitali i regjistruar	Rezerve ligjore	Rezerva te tjera	Rezerva e rivleresimit	Fitime te mbajtura	TOTAL
Balanca e hapjes						
Me 01 Janar 2013	100,000				25,504,057	25,604,057
Axhustime per vitin e kaluar	-	-	-	-	-	-
Balanca e hapjes e axhustuar	100,000	-	-	-	25,504,057	25,604,057
Me 01 Janar 2014	100,000	-	-	-	18,214,020	18,314,020
Fitimi/ (Humbja) e vitit	-	-	-	-	237,555	237,555
Shtim Kapitali		-	-	-	-	-
gjithperfshirese	100,000	-	-	-	18,451,575	18,551,575
Transferim ne reserve	-					-
Dividente te paguar	-	-	-	-		-
Me 31 Dhjetor 2014	100,000	-	-	-	18,451,575	18,551,575
						-
Me 01 Janar 2015	100,000	-	-	-	18,451,575	18,551,575
Fitimi/ (Humbja) e vitit	-	-	-	-	663,797	663,797
Shtim Kapitali		-	-	-	-	-
gjithperfshirese	100,000	-	-	-	19,115,372	19,215,372
Transferim ne reserve	-					-
Dividente te paguar	-	-	-	-		-
Me 31 Dhjetor 2015	100,000	-	-	-	19,115,372	19,215,372

Shënimet shpjeguese në faqet 1 - 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015*(Vlerat janë shprehur në LEK)*

	Për vitin e mbyllur Shënime më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukse monetare nga veprimtari shfrytëzuese:		
Fitimi pas tatimit	663,797	237,555
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	1,096,621	1,376,990
Humbjen nga Kembimet valutore		(35,682)
Humbje nga shitja e aktiveve afatgjata		(576)
Shpenzimet për Tatim fitim	-	-
<i>Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues</i>	<u>1,760,418</u>	<u>1,578,287</u>
Zvogëlimi / (rritja) e inventarëve	-	-
Zvogëlimi / (rritja) e kërkesave për arkëtim	(2,034,321)	7,534,889
(Zvogëlimi) / rritja e llogarive të pagueshme	<u>(531,231)</u>	<u>(8,623,568)</u>
	<u>(805,134)</u>	<u>489,608</u>
Interes i paguar		
Interes i arkëtuar		
Tatim fitimi i paguar		(287,496)
Paraja neto nga aktivitetet operative	<u>(805,134)</u>	<u>202,112</u>
Flukse monetare nga veprimtaritë investuese:		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(223,278)	
Blerje e aktiveve afatgjata jo-materiale		
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	15,707	
Paraja neto nga aktivitetet investuese	<u>(207,570)</u>	<u>-</u>
Flukse monetare nga veprimtaritë financuese:		
Arkëtime nga derdhja e kapitalit	-	0
Arkëtime nga huamarrjet dhe qiratë financiare	-	0
Arkëtime nga përdorimi i kredisë kufi	-	0
Paraja neto veprimtaritë financuese	<u>-</u>	<u>0</u>
Pakësimi neto i mjeteve monetare	<u>(1,012,704)</u>	<u>202,112</u>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	4,664,797	4,462,685
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	<u>3,652,093</u>	<u>4,664,797</u>

Shënimet shpjeguese në faqet 1-16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Administratori
Glion Bakalli



1. Informacion i përgjithshëm

Optima Communication sh.p.k. (referuar si "Optima" ose "Shoqëria") është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) më datë 26 dhjetor 2006.

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit 9901, datë 14 prill 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe nga statuti i saj. Aktiviteti i Shoqërisë konsiston në ofrimin e shërbimeve grafike dizajn, editori, dizajn faqe web, grafike multimediale, fushata promovionale prodhimesh, fushata sociale, packaging, reklama, ilustrime, broshura, katalogje elektronike dhe aktivitete të tjera në fushën e grafike dizajn. Shoqëria zotërohet 40 % nga ortakët Z. Glon Bakalli, 40 % nga ortakët Z. Ilir Daci dhe 20 % nga ortakët Z. Niko Qirici.

Vlera e kapitalit themeltar është 100.000 Lekë, e ndarë në 3 kuota me vlerë nominale respektivisht 40.000 lekë, 40.000 lekë dhe 20.000 lekë për kuota. Administrator i Shoqërisë është Z. Glon Bakalli. Shoqëria disponon ambiente në Tiranë që ndodhen në Ibrahim Rugova, Sky Tower, 5/4.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2015 është 1 (një).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Përputhshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të shpallura me datë 15 qershor 2006 në përputhje me Ligjin 9228, datë 29 prill 2004 të ndryshuar me ligjin 9477, datë 9 shkurt 2006, dhe të përmirësuara në përputhje me Urdhërin e Ministrisë të Financave nr.64, datë 22.07.2014, në fuqi nga data 1 janar 2015.

2.2 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e vijimësisë. Aksioneri kryesor i Shoqërisë ka garantuar financimin e nevojshëm për shlyerjen e detyrimeve të Shoqërisë për 12 muajt e ardhshëm. Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë më 31 dhjetor 2015 janë paraqitur duke u nisur nga supozimi se Shoqëria do të jetë në gjendje t'i arkëtojë dhe t'i shlyejë këto të drejta dhe detyrime gjatë rrjedhës normale të biznesit.

2.3 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe.

Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumëve të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. Politikat kontabël kryesore

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në fillim dhe në fund të periudhës. Të drejtat dhe detyrimet jomonetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit të përdorura në konvertimin e aseteve dhe detyrimeve monetare në monedhë të huaj janë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Euro/Lek	137.28	140.14

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë joderivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë joderivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç sa më poshtë. Për instrumentat e mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë joderivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar dhe mospagesa apo pagesa e vonuar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua me interes të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

Të tjera

Instrumenta të tjerë joderivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Instrumentet financiare klasifikohen si asete afashkurtra me përjashtim të rasteve kur shoqëria ka një të drejtë pa kusht për ta shtyrë pagesën e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave përafrohen me vlerat e tyre kontabël për shkak ose të natyrës së tyre afatshkurtër ose të normës së interesit e cila i përafrohet normës së tregut.

3.3 Aktive të qëndrueshme jomateriale

Aktivitet e qëndrueshme jomateriale që kanë një jetë të përcaktuar maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet mbi koston e blerjes së aktivitet e zvogëluar me vlerën e tij të mbetur. Shuma e amortizimit kalon në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë lineare përgjatë jetës së aktivitet.

3.4 Aktive të qëndrueshme materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin, nëse ka, dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga data e vënies në përdorim. Aktivet e marra me qira amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit dhe duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Metodat dhe përqindjet e amortizimit të aktiveve afatgjata për periudhën 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje dhe programe IT	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Mjete transporti e të tjera	Mbi vlerën kontabël neto	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.5 Zhvlerësimi***Aktivitet financiar***

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet të tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivitet jofinanciar

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ekzistojnë tregues të zhvlerësimit. Nëse ekzistojnë tregues të tillë, vlera e rikuperueshme vlerësohet.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e aktivit ose e njësisë së gjenerimit të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme të tij. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.6 Përfitimet e punonjësve

Fondet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe pensione

Bazuar në legjislacionin shqiptar, Shoqëria është e detyruar të paguajë në emër të punonjësve të saj kontribute të detyrueshme në një fond social të menaxhuar nga shteti. Pagesat dhe detyrimet e mbuluara nga Shoqëria njihen si shpenzime në periudhën të cilës ato i përkasin.

3.7 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.8 Njohja e të ardhurave

Shitja e shërbimeve

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.9 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare, huatë e dhëna dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.10 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyre. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet si fitim ose humbje përveç nëse lidhet me zera të njohur direkt në kapital, rast në të cilin njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi që pritët të paguhet mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke përdorur normen tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshem për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyre lind nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet e shoqërisë të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me kërkesat e SKK dhe vlerave të njohura të këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore.



Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

4. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktivitet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbëhen si më poshtë:

Aktive afatgjata materiale

	Pajisje zyre, moblie	Pajisje informatike	Mjete transporti	Totali i Aktiveve Fikse
AQT me kosto historike				
Teprica me 1 Janar, 2015	1,045,958	2,945,856	5,050,321	9,042,135
Shtesa nga blerjet	116,694	106,584	-	223,278
Transferime nga zëra të tjerë	-	(54,158)	-	(54,158)
Teprica me 31 Dhjetor, 2015	1,162,652	2,998,282	5,050,321	9,211,255
Amortizimi akumuluar				
Teprica me 1 Janar, 2015	(517,534)	(1,978,061)	(1,361,180)	(3,856,775)
Shtesa e vitit	(111,989)	(246,805)	(737,828)	(1,096,621)
Transferime nga zëra të tjerë	-	38,451	-	-
Teprica me 31 Dhjetor, 2015	(629,523)	(2,186,415)	(2,099,008)	(4,953,396)
Balanca me 31 Dhjetor, 2015	533,130	811,867	2,951,313	4,296,309

5. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE

Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, Shoqëria nuk disponon aktive afatgjata jomateriale.

6. INVENTARI

Për shkak të natyrës së aktiviteteve të kryera nga Shoqëria gjatë viteve 2015 dhe 2014, Shoqëria nuk ka gjendje inventari.

7. KËRKESA PËR T'U ARKËTUAR

Kërkesat për t'u arkëtuar më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbëhen si më poshtë:

Kërkesa të arkëtueshme

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Kliente	2,732,282	1,438,551
Tatim fitim	949,261	1,293,883
Kërkesa të tjera të arkëtueshme	8,978,368	8,268,156
TOTALI	12,659,912	11,000,590

8. TË TJERA PËR T'U ARKËTUAR

Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, kërkesat e tjera për t'u arkëtuar janë si më poshtë vijon:

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Te tjera për t'u arkëtuar dhe shpenzime për t'u shpërndarë

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Garanci	279,000	279,000
Shpenzime për t'u shpërndarë	375,000	-
TOTALI	654,000	279,000

9. MJETET MONETARE

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbëhen si më poshtë:

Mjetet monetare

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Llogari rrjedhëse:		
Lek	568,386	517,145
Euro	102,982	324,253
	671,368	841,398
Arka:		
Lek	2,980,725	3,823,399
Euro	-	-
	2,980,725	3,823,399
TOTALI	3,652,093	4,664,797

10. KAPITALI

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqitet si më poshtë vijon:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Kapitali	100,000	100,000
TOTALI	100,000	100,000

11. DETYRIMET PËR T'U PAGUAR DHE PARAPAGIMET

Detyrimet për t'u paguar

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Furnitorë:	1,753,235	2,431,230
Tatime dhe taksa:		
Tatim mbi të ardhurat personale	29,625	33,460
Sigurime Shoqërore	30,651	47,251
TVSH	233,431	66,232
Të tjera		
TOTALI	2,046,942	2,578,173

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

12. TË ARDHURA

Te ardhurat e shoqërisë gjatë vitit 2015 dhe 2014 paraqiten si me poshtë vijon:

Te ardhura

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Te ardhura nga sherbimi	10,106,065	10,163,449
Te ardhura te tjera	54,158	
TOTALI	10,160,223	10,163,449

13. KOSTO E PUNËS

Kostoja e punës gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbëhet si me poshtë:

Kostot e punes

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Pagat e personelit	(2,427,372)	(3,139,680)
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	(215,928)	(333,140)
TOTALI	(2,643,300)	(3,472,820)

14. SHPENZIME ADMINISTRATIVE

Shpenzimet administrative gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbëhen si më poshtë:

Shpenzime administrative

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Sherbime printi	(600,000)	(280,540)
Sherbime noteriale	(45,833)	(1,000)
Sherbime Design	(2,341,789)	(856,480)
Sherbim fotografik	(85,444)	-
Sherbim realizim video	(238,425)	(168,396)
Sherbime perkthimi	(5,500)	(12,000)
Shpenzime Kancelarike	(10,833)	(18,305)
Blerje Promocioni	(16,737)	-
Hostim domain	(5,000)	-
Shpenzime kreative	(1,037,051)	(2,949,299)
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	(113,922)	(154,756)
Shpenzime te tjera	(744,349)	(470,966)
TOTALI	(5,244,883)	(4,911,742)

15. TË ARDHURA (SHPENZIME) FINANCIARE, NETO

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Të ardhurat (shpenzimet) financiare gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbëhen si më poshtë:

Te ardhura dhe shpenzime financiare

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Te ardhura nga interesa bankare	596	576
Shpenzime për interesa	(15)	(467)
	581	109
Fitime të realizuara nga kursi kembimit	44,031	48,004
Humbje të realizuara nga kursi kembimit	(144,930)	(8,874)
	(100,899)	39,130
Komisione bankare	(66,680)	(65,508)
TOTALI	(166,998)	(26,269)

16. TATIM- FITIMI

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyre. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet si fitim ose humbje përveç nëse lidhet me zera të njohur direkt në kapital, rast në të cilin njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke përdorur normen tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshem për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyre lind nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet e shoqërisë të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me kërkesat e SKK dhe vlerave të njohura të këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore.

Tatim-fitimi

Rakordimi i humbjes kontabel me humbjen fiskale

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Fitimi (humbja) e vitit	1,008,420	375,628
Rregullime për zëra shpenzimesh të panjohura:	1,289,069	544,861
Fitimi (humbja) fiskale e vitit	2,297,489	920,489
Tatim fitim 2015	344,623	138,073
Fitimi (humbja) fiskale e vitit neto	1,952,866	782,416
Parapagim tatim fitim	1,293,884	1,431,957
Balanca TF për vitin pasardhës	(949,261)	(1,293,884)

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15 % për vitin 2015.

Deklaratat tatimore dorëzohen cdo vit por të adhurat dhe shpenzimet e deklaruar për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe bëjnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritet tatimore. Për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, Shoqëria ka rezultuar me fitim kontabël dhe fiskal.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Tatim-fitimi	344,623	138,073
TOTALI	344,623	138,073

Këto pasqyra financiare u aprovuan dhe u nënshkruan nga Drejtimi i Shoqërisë më 24, Mars 2016:

Administrator

Glion Bakalli



Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Shoqëria Optima Communication Shpk
NIPT K71903025A

Aktivitet Afatgjatë Materiale me vlerë fillestare 2015

Nr	Emertimi		Gjendje 01/01/2015	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2015
1	Toka					0
2	Ndertime					0
3	Makineri,paisje Instalime		2,397,418	-		2,397,418
4	Mjete transporti		5,050,321			5,050,321
5	Mobilje Orendi		1,045,958	116,694		1,162,652
6	Paisje Infomatike		548,438	106,584	-54,158	600,864
TOTALI			9,042,135	223,278	-54,158	9,211,255

Amortizimi A.A.Materiale 2015

Nr	Emertimi		Gjendje 01/01/2015	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2015
1	Toka					0
2	Ndertime					0
3	Makineri,paisje Instalime		1,727,854	167,391		1,895,245
4	Mjete transporti		1,361,180	737,827		2,099,007
5	Mobilje Orendi		517,534	111,989		629,523
6	Paisje Infomatike		250,207	79,414	38,451	329,621
TOTALI			3,856,775	1,096,620	38,451	4,953,396

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2015

Nr	Emertimi		Gjendje 01/01/2015	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2015
1	Toka					0
2	Ndertime					0
3	Makineri,paisje Instalime		669,564	167,391		502,173
4	Mjete transporti		3,689,141	737,827		2,951,314
5	Mobilje Orendi		528,424	- 4,706		533,129
6	Paisje Infomatike		298,231	- 27,169	-15,707	309,693
TOTALI			5,185,360	873,343	-15,707	4,296,309

Administratori
GLON BAKALLI



Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Shoqeria Optima Communication Shpk**NIPT K71903025A**

Inventari automjeteve ne pronesi te subjektit 2015

Nr.	Lloji automjetit	Kapaciteti	Targa	Vlera e mbetur
1	Hyundai I10	4+1	AA738FP	598,780
2	Mini Countryman	4+1	AA941DF	1,910,204
3	Hyundai I10	4+1	AA413AP	442,329
Shuma				2,951,313

Shoqeria Optima Communication Shpk**NIPT K71903025A**

Inventari ne pronesi te subjektit 2015

Nr.	Lloji i mallit	Cope	Cmimi	Vlera
Shuma				0

Keto pasqyra financiare jane nenshkruar nga Administratorit i Shoqerise, me 24, Mars 2016.

Administrator

